

Performanca e Buxhetit 2018



NË KËTË RAPORT

Periudha raportimit: Janar - Dhjetor 2018

Statusi raportit: Raporti bazohet në të dhëna të konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Peqin gjatë vitit 2018 dhe është miratuar në Këshillin Bashkiak

Përmbledhje mbi situatën financiare, të ardhurat, shpenzimet sipas programeve si edhe rezultatet kryesore të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2018

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Peqin me asistencën e Projektit "Bashki të Forta". Për më shumë informacion kontaktoni Zj.Xhemile Lila në adresën xh.lila@yahoo.com

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME



Popullsia: Censuri (2011) 26.136 banorë
Rregjistri Civil 38.900 banorë
Sipërfaqja: 197.79 km²
Dendësia: Censuri (2011) 132 banorë/km²
Rregjistri Civil 196.67 banorë/km²


Nëndarjet Administrative: 6

(1) Peqin (2) Pajovë (3) Karinë (4) Përparim (5) Gjocaj (6) Shezë

Rezultatet në zgjedhjet vendore të vitit 2015 si më poshtë:



Shpërndarja e anëtarëve:



EKZEKUTIVI Numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Bashkinë Peqin për zgjedhjet vendore të vitit 2015 ishte 28.731 persona. Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet e fundit lokale ishte 48.14%. Këshilli bashkiak përbëhet nga 21 anëtarë të grupuar midis partive politike PDIU, LSI, PD, PS, PDS.

Kryetari i Bashkisë është **Z. Saimir HASALLA**.

departamentet e Bashkisë përfshijnë: finance dhe buxhet, tatim taksa vendore, politikat e zhvillimit, shërbimet publike, bujqësia dhe pyjet, shërbimet sociale, planifikim dhe kontrolli i teritorrit, mbrojtja e teritorrit, ligjore, administratë dhe burimet njerëzore, arsim dhe edukim;

EKONOMIA Bashkia e re e Peqinit shtrihet përgjatë rrugës së vjetër Egnatia, ndërsa kalaja Klaudiana në qendër të qytetit është dëshmi e lashtësisë së këtij vendbanimi. Qyteti dhe të 50 fshatrat e kësaj bashkie shtrihen në një zonë fushore dhe kodrinore.

Banorët e bashkisë së Peqinit janë të orientuar ndaj bujqësisë dhe vreshtarisë, por edhe mbarështimit të shpendëve. Kultivimi i ullinjve, i perimeve të serave dhe i produkteve të tjera bujqësore janë gjithashtu karakteristikë e zonës. Peqini është i njohur për rritjen e gjelit të detit, mjaft i kërkuar në të gjithë Shqipërinë në kohë festash si dhe për sportin e ndeshjeve me gjela. Bizneset janë kryesisht të përqendruar në shërbime, ndërkohë që në Peqin janë ngritur edhe disa punishte për vajin e ullirit.

SITUATA FINANCIARE

Objektivat e bashkisë Peqin

- ⇒ Të shndërojë bashkinë në qendër të zgjidhjes së problemeve sociale dhe të ndihmës për çdo qytetar
- ⇒ Të shkurtohen diferencat në zhvillim, shërbime e infrastrukturë mes zonave më të largëta e më të varfra të bashkisë dhe qendrës së saj.
- ⇒ Bashkia të shpërohet në një njësi bazë për zhvillimin ekonomik të vendit, duke nxitur zhvillimin e sektoreve ekonomike sipas karakteristikave të zonës së Peqinit .
- ⇒ Të shkurtohen distancat dhe të rritet aksesimi në punësim, arsimim dhe shërbim të familjes peqinase në çdo njësi administrative

SHËRBIMET DHE TË ARDHURAT 2018

Burimet e financimit Buxheti 2018


- ⇒ Transferta e pakushtëzuar (granti)
 - ⇒ Transferta specifike
- ⇒ Të ardhurat nga burimet e veta
- ⇒ Të ardhura të trashëguara nga viti 2017
- ⇒ Transfertat e kushtëzuara

Buxheti për vitin 2018 = 410.906 mijë lekë


Shërbimet kryesore të ofruara dhe financuara nga bashkia janë

- | | |
|--|---|
| ⇒ Administrim, Menaxhim | ⇒ Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit |
| ⇒ Shërbimet Publike Vendore | ⇒ Menaxhimi i Transportit Rrugor |
| ⇒ Kulturë dhe Turizëm | ⇒ Rrjeti i Rrugeve Nacionale |
| ⇒ Zhvillimi i Sportit | ⇒ Ujësjetës Kanalizime |
| ⇒ Arsimi Bazë (përfshirë parashkollorin) | ⇒ Programe Zhvillimi |
| ⇒ Arsimi i mesëm (i përgjithshëm) | |
| ⇒ Emergjencat | |
| ⇒ Administrimi i Pyjeve | |


Shpenzimet e realizuara për vitin 2018 = 324.818 mijë lekë



TË ARDHURAT 2018



Burimi: Bashkia Peqin, Financat Vendore



Burimi: Bashkia Peqin, Financat Vendore


SHPENZIMET

Bashkia Peqin i kushton vëmendje gjithnjë e më shumë në rritje shërbimeve të administrimit, arsimit dhe infrastrukturës rrugore.

Programet buxhetore më të financuara gjatë vitit 2018, që përbëjnë rreth 87% të buxhetit janë:


- A. Planifikim, Menaxhim, Administrim
- B. Arsimin bazë dhe parashkollor
- C. Menaxhimi i transportit rrugor
- D. Shërbimet publike vendore

Shpenzime sipas programeve, % ndaj totalit të Buxhetit, 2018



Programi me realizimin më të lartë është "Shërbime Publike", kurse programi "Ujitja dhe Kullimi" ka ekzekutimin më të ulët

Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore në Loka



Bazimi informacioni: "Raporti i Menaxhimit 2018 - Bashkia Peqin"

SHPENZIMET

Në grafik paraqitet përqindja e realizimit të shpenzimeve ndaj planifikimit, ndërsa tabela më poshtë liston investimet më të rëndësishme të bashkisë.

Shpenzimet sipas Klasifikimit Ekonomik në Lekë

Administrim, Mbrojtje



Burimi i Informacionit:

"Raporti i Menaxhimit 2018 - Bashkia e Pezës"

Projektet e Investimeve në Lekë

Emertimi	Vitet	Wbaxor	Realizimi (Fakt 2018)	% Realizimit	
Ardhësi i rrugës Trade	2017	Null	10,761,000	24.752%	
Konstruksion i qesjes së Kercës	2016	2018	2,604,000	24,309,000	129.90%
Wërtim i ujit në varrezat e Fatoles	2018	2018	0	995,000	
Wërtim i ujit në Kullajve, Terebia 1 dhe 2	2018	2018	1,461,000	1,461,000	100.00%
Wërtim i ujit në fshatin Fatoles	2018	Null	1,000,000	157,000	15.70%
Rrëzimi i rrugës Ali Ceka	2018	2018	2,444,000	2,444,000	100.00%
Rikonstruksion i rrugës Kërës vllërit	2017	Null	14,300,000	11,300,000	80.67%
Rikonstruksion i rrugës Xhani	2018	2018	0	700,000	
Rikonstruksion i rrugës Aden Gjiniç	2017	2018	0	1,487,000	
Rikonstruksion i rrugës në rrugës Beskëse	2016	2018	0	7,689,000	
Rikonstruksion i shkollës Deme Godefi	2018	Null	0	35,029,000	
Rikonstruksion i shkollës Shënjtorë Gjocaj	2017	Null	0	59,528,000	
Rikonstruksion i qesjes së Sinemetaj	2018	Null	490,000	490,000	100.00%
Rikonstruksion i rrugës në Seranes	2017	Null	0	2,485,000	
Rikonstruksion i rrugës dhe rrugës kryesore Pejë - Elbasan	2016	Null	0	135,822,000	
Riparim i Sheshit Shez	2018	2018	785,000	785,000	100.00%

Burimi i Informacionit:

"Raporti i Menaxhimit - Bashkia e Pezës"

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Rezultatet vjetore të treguesve të performancës buxhetore



Bashkia ka rritur performancën e përdorimit të fondeve buxhetore. Kjo rritje ka ardhur edhe në sajë të rritjes së transparencës së vendimarrjes bashkiake.

Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak kanë qenë të hapura dhe pjesa më e madhe e vendimeve që detyrojnë konsultimin me publikun janë diskutuar paraprakisht me banorët.

Disa arritje të rëndësishme të përmirësimit të shërbimeve ofruar komunitetit vendor falë rritjes jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të kapaciteteve njerëzore të bashkisë janë renditur më poshtë nëpërmjet treguesve të performancës sipas programeve.

PROGRAM

PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM

OBJEKTIVA

Menaxhimi i detyrimeve të prapambetura

Rritja e numrit të bizneseve

TREGUES PERFORMANCE


TP 1. Trendi i detyrimeve të prapambetura në vite

TP 2. Numri i bizneseve aktiv (trendi vjetor në %)

Realizimi i shpenzimeve : 84% e vlerës së parashikuar (90.021 mijë lekë, 28% e buxhetit

Punonjës të dedikuar në administratën e bashkisë = 178

Administrim, Menaxhim ne mijë Leke



PROGRAMI

MENAXHIMI I TRANSPORTIT RRUGOR

Objektivi i programit

Zhvillimi i një qyteti të qëndrueshëm me cilësi të mirë jetese për banorët e tij.


Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimi rrugor, i trotuareve dhe shesheve publike vendore. Funksimi i transportit publik urban

Realizimi i shpenzimeve :

56% e vlerës së parashikuar
(45.641 mijë lekë, 14% e buxhetit)

TREGUES PERFORMANCE:

- ◆ **TP 1.** Rehabilitimi i infrastrukturës në zonat ku janë parashikuar zhvillime urbane
- ◆ **TP 2.** Rrugë me cilësi të lartë dhe zhvillim urban me hapësira të reja publike
- ◆ **TP 3.** Ndërtimi i terminalit të autobuzëve



PROGRAMI

KULTURA

Objektivi i programit


Krijimin e një jete sa më të pasur kulturore dhe sociale

Bashkia nëpërmjet fondeve të saj synon që ti japë një hapësirë më të plotë jetës artistike dhe kulturore, jo vetëm duke u mbështetur në rivitalizimin e mëtejshëm të projekteve ekzistuese, të cilat janë kthyer tashmë në një traditë, por edhe duke dhënë hapësira të reja për projekte të tjera inovative. Ky program do të tentojë të promovojë vlerat kulturore të Bashkisë Peqin

Realizimi i shpenzimeve : 80% e vlerës së parashikuar (5.627 mijë lekë, 2% e buxhetit)

TREGUES PERFORMANCE:

- ♦ **TP 1.** Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.



PROGRAMI

ARSIMI PARASHKOLLOR

Objektiva:
Ofrimin e kushteve optimale për mirërritjen e fëmijëve

Sigurimin e një infrastrukture arsimore bashkëkohore për nxënësit
Sigurimin e ngrohjes në objektet arsimore.

Bashkia nëpërmjet fondeve buxhetore të saj mbështet veprimtarinë e shërbimit në arsimin parashkollor, duke krijuar kushte sa më optimale për arsimin parashkollor, si dhe duke përdorur burimet financiare në mënyrë efçente, efektive dhe ekonomike.


Realizimi i shpenzimeve : 95% e vlerës së parashikuar (170.580 mijë lekë) dhe 33% e buxhetit

TREGUES PERFORMANCE

- ♦ **TP 1.** Përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit në cilësinë e shërbimeve ndaj institucioneve arsimore si dhe në forcimin e kontrollit të fondeve të planifikuara në buxhetin e arsimit
- ♦ **TP 2.** Ngrohja në objektet arsimore



Arsimi baze dhe parashkollor
ne mije Leke



PROGRAMI

MBROJTJA NGA ZJARRI DHE EMERGJENCAT CIVILE

Objektiva

Parandalimi me masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, ndërhyrja në shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore apo të shkaktuara nga dora e njeriut.


TREGUES PERFORMANCE

- ♦ **TP 1.** Plotësimi i strukturës së MZSH me personel; pajisje dhe mjete
- ♦ **TP 2.** Mbulimi i gjithë territorit me shërbim e MZSH
- ♦ **TP 3.** Parandalimin e rasteve nga zjarri nëpërmjet rritjes së monitorimit
- ♦ **TP 4.** Evidentimin e dëmeve në rastet e dëmtimit nga zjarri dhe fatkeqësi natyrore

Realizimi i shpenzimeve : 75% e vlerës së parashikuar (11.478 mijë lekë, 4% e buxhetit)



Emergjencat ne mijë Leke



PROGRAMI

UJITJA DHE KULLIMI

Objektiva


- ⇒ Rehabilitimi dhe rikonstruksioni i veprave ujitëse
- ⇒ Investime në rrjetin e kanaleve ujitëse

Realizimi i shpenzimeve : 26% e vlerës së parashikuar (2.876 mijë lekë, 1% e buxhetit)

TREGUES PERFORMANCE

Bashkia ndihmon komunitetin në pjesën rurale për të rritur shfrytëzimin e tokës bujqësore nëpërmjet mirëmbajtjes së sistemit të kanaleve dytësore dhe tercare vaditëse dhe kulluese.

- ◆ **TP 1.** % e sistemit të kanaleve kulluese të pastruara
- ◆ **TP 2.** % e sistemit të kanaleve vaditëse të pastruara



PROGRAMI

SHËRBIME TË PËRGJITHSHME VENDORE

Objektivi i programit


Bashkia mbështet zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve publike

Realizimi i shpenzimeve : 90% e vlerës së parashikuar (48.402 mijë lekë, 15% e buxhetit)

TREGUES PERFORMANCE:

- ◆ **TP 1.** Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %)
- ◆ **TP 2.** Rrënjë pemë të mbjella kundrejt totalit të pemëve për të cilat kujdeset / fondi pemëve të bashkisë (në %)
- ◆ **TP 3.** Total km linear trotuar kundrejt vitit të kaluar (ndryshimi në %)
- ◆ **TP 4.** Rritja e efijencës buxhetore në ofrimin e shërbimit të gjelbërimit (Lekë të ardhura nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifat **vendore (në %)**)

Shërbimet publike vendore në mijë Leke



PROGRAMI

UJI I PIJSHËM DHE KANALIZIMET


Objektiva

- ⇒ Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ujit të pijshëm
- ⇒ Përmirësimi i menaxhimit të ujërave të përdorura (zeza dhe bardha) / shërbimeve sanitare

TREGUES PERFORMANCE

- ◆ **TP1.** Popullsia e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm dhe kanalizime në %
- ◆ **TP2.** Norma e arkëtimit të tarifave në %
- ◆ **TP3.** Norma e mbulimit të kostove të shërbimit nga të ardhurat e realizuara nga tarifa e shërbimit në %
- ◆ **TP4.** Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm në 24 orë

Performanca e shërbimit ujë i pijshëm dhe kanalizime 2016-2018



Kohëzgjatja e u furnizimit me ujë të pijshëm (orë në ditë)

